



Zahir Gashi  
Auditor  
Rr : Garibaldi nr 17  
Prishtinë, Kosovo  
Phone: 0 44 233 566  
Email: [zahirgashi@hotmail.com](mailto:zahirgashi@hotmail.com)



**Qendra e Kosovare për Studime të Sigurisë**

## **RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR**

### **2011**

Përmbajtja:

Faqe

Përmbajtja .....	2
Hyrje.....	3
Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare .....	3
Përgjegjësit e Auditorit .....	3
Opinion.....	3
Shënimet e përgjithshme mbi subjektin e ndërmarrjes .....	4
Objektivat e auditimit .....	4
Burimet njerëzore .....	5
Pasqyra e politikave të brendshme të kontabilitetit.....	5

## I Hyrje

Kemi audituar pasqyrat financiare të QKSS për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2011 të cilat përmbajnë Pasqyrën e të ardhurave dhe bilancin e gjendjes

## II Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti i QKSS është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të Pasqyrave Financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, në mënyre që të mos ketë gabime material si pasojë e mashtrimit apo mos funksionimit të mirëfilltë të kontrollës së brendshme.

## III Përgjegjësit e Auditorit

Përgjegjësia e auditorit është që të shpreh opinionin për këto pasqyra financiare, të bazuar në auditimin e kryer. Ne kemi zhvilluar auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që të jemi në përputhje me kërkesat etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të fituar siguri të arsyeshme se këto pasqyra financiare nuk kanë gabime material.

Auditimi përfshinë intervistat me menaxhmentin, ekzaminimin e dokumentacionit, në bazë të testeve, dhe të dhënave në mbështetje të dëshmimeve dhe shumave të shpalosura në pasqyrat financiare. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe përlllogaritjet materiale të kryera nga menaxhmenti si dhe vlerësimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmitë që i kemi marrë, janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

## IV Opinioni

Në bazë të testeve të kryera dhe ekzaminimit të dëshmimeve të ofruara, mund të konstatojmë se pasqyrat financiare të audituara për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2011, të QKSS paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtet në të gjitha aspektet materiale, si dhe shpalosjet e pasqyrave financiare janë në harmoni me standardet Kosovare të Kontabilitetit. Bazuar në këto vlerësime paraqesin **opinion pa rezerve- pa kualifikuar** për paraqitjen e pasqyrave financiare nga QKSS.

” Kontabilitet & Auditim” SH.P.K.

Zahir Gashi, Auditor

Prishtine: 17/09/2012



## **V Shenimet e përgjithshme mbi subjektin e organizatës**

**QKSS** aktivitetin e vet e ushtron nga data 17 Prill 2008 dhe operon me numër të regjistrimit 5111840-5 dhe me numër fiskal 600278685, me seli në Prishtinë. Përfaqësues i autorizuar i QKSS është Florian Qehaja.

**QKSS** posedon udhëzime të brendshme në baze të cilat kryhen aktivitetet e përditshme ku dendësohet edhe kontrollimi brendshëm. Menaxheri i subjektit për çdo ditë mban takime dhe këshillime të shkurtra me punëtor, i këshillon dhe i udhëzon për detyrat e punës të cilat duhen të kryejnë punëtorët, dhe kështu përmban një procesverbal mbi takimet të cilat i mbanë dhe detyrat për punë. Ndarja e detyrave tek punëtorët është desidive, çdo punëtor kryen punën e tij sipas udhëzimeve të menaxherit. Sistemi i kontrollës së brendshme është në nivel të duhur, çdo punë e punëtorit kontrollohet nga menaxheri i tij. Struktura e kapitalit është homogjene.

## **VI Objektivat e auditimit**

Objektivë kryesorë e këtij Auditimi ishte të shprehim një opinion nëse pasqyrat financiare të vitit që përfundon me 31 Dhjetor 2011 në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me standardet e kërkuara të kontabilitetit.

Kemi zgjedhur strategjinë e mos mbështetjes (testeve të pavarura), në kontrollin e brendshëm, kemi bërë biseda në nivelin e duhur të Menaxhmentit, mbikëqyrësve dhe personelin tjetër.

Për auditimin e raporteve, dokumentacionit dhe dosjeve elektronike kemi fituar një siguri të arsyeshme tek mbajtja e kontabilitetit, i cili përfshinë, regjistrimet kontabël dhe sistemin e të dhënave me program të sofistikuar të kontabilitetit të cilit në çdo kohë mund të nxirren raporte të nevojshme dhe të na ofroje shënime të plota në formën e cilën e kemi kërkuar, këto raporte janë të mbështetura me dokumentacion burimor.

Gjatë procedurave audituse në baze të asaj që kemi arritur të shohim mund të konstatojmë se kontrollohen të gjitha raportet ditore, mujore dhe dokumentet tjera financiare kryhen nga disa nivele duke filluar nga menaxheri i kontabilitetit deri tek drejtori gjeneral i kompanisë.

Të gjitha faturat janë të nënshkruara dhe të vulosura nga përgjegjësit dhe janë të aprovuara nga personeli përgjegjës.

Deklarata e Pajtuëshmërisë: Pasqyra Financiare janë në pajtuëshmëri me Standardet Kosovare të Kontabilitetit. Pasqyra e të ardhurave e fundvitit është e paraqitur në një format I cili është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Deklarata e Përgatitjes : Pasqyrat Financiare janë të përgatitura në bazë të kostove historike.

## **VII Pasqyrat e politikave të brendshme të kontabilitetit**

### **1. Politika kontabël, krahasueshmëria, pajtueshmëria**

Politikat e pranuar për përgatitjen e pasqyrave financiare, që përfshin metodat e zgjedhura të kontabilitetit janë Standardet Kosovare të Kontabilitetit të aprovuara nga Bordi i Raportimit Financiar të Kosovës si dhe kërkesat tjera për raportimin që janë të parashikuara me ligje. Periudha raportuese përfshin periudhën e vitit 2011

### **2. Stoqet**

QKSS nuk ka stoqe.

### **3. Te hyrat**

Të hyrat njihen kur kryhen shërbimet për punët e përfunduara sipas marrëveshjes së parapare, konkretisht kur lëshohet fatura në baze të punëve të përfunduara, apo furnizimeve të kryera. Gjate vitit 2011 QKSS ka gjeneruar të hyra në vlerë prej **82,508 euro**.

### **4 Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative**

Shpenzimet e ndodhura gjate gjenerimit të periudhës janë njohur për atë periudhë. Shpenzimet janë të njohura sipas kostos historike, pra janë të shprehura në vlerën reale në momentin e ndodhjes së shpenzimit dhe janë 30,481 euro.

Shpenzimet e pagave bruto përfshijnë 52,027 euro.

### **5. Llogaria e pagueshme**

Llogaritë e pagueshme njihen kur shuma është e përcaktueshme dhe obligimi për të paguar këtë shumë ekziston si rezultat i veprimtarive Ekonomike, por QKSS për vitin 2011 nuk ka paraqitur obligime për kryerjen e pagesave në forme të llogarisë së pagueshme, çdo aktivitet të kryerjes së pagesës e ka kryer çdo herë në kohën e duhur dhe sipas marrëveshjes.

## **6 Paraja e Gatshme**

Paraja e gatshme në fund të periudhës përbëhet nga pjesa e mbetur e parave në dore(arke) si prani fizike të tyre dhe në llogari të bankave komerciale të Kosovës. QKSS transaksionet financiare I kryen përmes Bankave komerciale siç shihet nga raporti i bankës.

## **7 Pasuria jo qarkulluese**

Pasuritë janë makineri dhe mjete pune për zhvillimin e veprimtarisë, dhe rritjen e aktiviteteve të saj operuese, të cilat janë në rritje nga viti ne vit.

## **9. Detyrimet kontingjente**

Sipas deklaratave të menaxhmentit ndërmarrja nuk ka pasur detyrime kontingjente dhe nuk do të pret të ketë detyrime kontingjente.

## **10 Parimi i vazhdimësisë**

Në baze të mjeteve të disponueshme, projekteve strategjike, me plane afatgjata, ndërmarrja nuk e vene aspak ne dyshim vazhdimësi e saj profesionale dhe funksionale për zhvillimin e saj operues.